



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË

Maliq më 21.12.2018

Hr 5066 Mtd

VENDIM
Nr. 131 Datë 14.12.2018

PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË MALIQ, PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2019

Mbështetur në gërmën “f”, të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjin 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, ligjin 8519 datë 30.07.1999 “Për ujëtimin dhe kullimin”, i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ligjin 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ligjin 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

VENDOSI:

- I. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Maliq si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2019 sipas materialit dhe pasqyrave bashkëngjitur;
- II. Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen;
- III. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave dhe të gjitha strukturat e tjera që kanë lidhje me këtë vendim ;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrin efektet nga 1 Janari 2019 e në vazhdim;

KRYETARI I KËSHILLIT
ERISELD JONUSLLARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË**

PAKETA FISKALE 2019

Mbështetur në gërmën “P”, të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjin 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, ligjin 8519 datë 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ligjin 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ligjin 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

VENDOSI:

A-TAKSA VENDORE

1. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) taksa mbi ndërtesat**
- b) taksa mbi tokën bujqësore**
- c) taksa mbi truallin**

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë

1.a) Taksa mbi ndërtesat

Llogaritja e taksës së ndërtesës është bërë në mbështetje të V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” nenit 2 pika 3 ku thuhet:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë)

për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësitëve të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. **Kjo taksë miratohet pa ndryshim si në vitin 2018.**

1. Taksa mbi ndërtesa për qëllime banimi në Maliq

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017	- 30% mbi shkallën e taksës
Banesa	13.9 (27800*0.05%)	9.7 lekë/m ² (13.9*70%)

2. Banesa për qëllime banimi në Njësi Administrative (Zona 2, Zona 3 dhe fshatrat e Zonës 1)

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 për zonën më të afërt (Qyteti Maliq)	-35% i çmimit mesatar referues
Banesa	13.9 (27800*0.05%)	9.7 (13.9*70%)	6.3 lekë/m ² (9.7* 65%)

3. Njësi tregëtimi dhe shërbimi.

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	+ 30% të çmimit mesatar referues
Njësi tregëtimi dhe shërbimi	200	83.4 (41700*0.2%)	108 lekë/m ² (83.4* 130%)

4. Veprimtari bujqësore dhe blegtorale.

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	+ 30% të çmimit mesatar referues
Veprimtari bujqësore dhe blegtorale	40 lekë	17 lekë (8340*0.2%)	22 lekë/m ² (17* 130%)

5. Parkime të mbyllura dhe bodrume.

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	+ 30% të çmimit mesatar referues
Parkime të mbyllura dhe bodrume	40 lekë	39 lekë (19460*0.2%)	50 lekë/m ² (39* 130%)

6. Parkim i hapur ne Bashki.

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	+ 30% i çmimit mesatar referues
Parkime të hapura në Bashki	40 lekë	17 lekë (8340*0.2%)	22 lekë/m ² (17* 130%)

7. Veprimtari industriale në Bashki.

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	+ 30% i çmimit mesatar referues
Veprimtari Industriale në Bashki	100 lekë	28 lekë (13900*0.2%)	36 lekë/m ² (28* 130%)

Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ë) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet nga pensionistë të vetëm ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.

Afatet e pagesës

1. Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim të shpërndahen në periudhën **Janar 2019 – Mars 2019**, dhe detyrimi vjetor për taksën mbi ndërtesës do të paguhet pranë sporteleve të Bashkisë Maliq ose pranë Njësive Administrative. Detyrimi vjetor do të paguhet brenda datës **30.09.2019**.
2. Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike do të paguhet brenda datës **30.06.2019**.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me **0,06** për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.

Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

-Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për biznesin është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq.

-Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për familjarët është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq, kurse për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësi administrative. ose agjenti tatimor i përzgjedhur (OSHEE. Ujesjellesi Maliq Sha),

1.b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit, është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës 30.09.2019. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin sipas vlerësimit të rastit në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën.

Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit sipas Ligjit	Vlera e taksës së propozuar -30% lekë/hektar/vit
I	4 200	2940
II	3 500	2450
III	2 800	1960
IV	2 300	1610
V	1 900	1330
VI	1 600	1120
VII-X	1 400	980

Përjashtime

Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore, tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq si dhe Njësitë Administrative

1.c) Taksa mbi truallin.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit dhe është detyrim vjetor i taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas

dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin sipas vlerësimit të rastit në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror.

Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi truallin është si vijon:

	Vlera e taksës lekë/ m²/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës lekë/ m²/vit për qëllime biznesi
Bashkia		
Bashkia Maliq	0,14 lekë/m²	12 lekë/ m²

Afatet e pagesës

- Detyrimi vjetor për kategorinë truall për qëllime banimi nga individët do të shpërndahe në periudhën **Janar 2019 – Mars 2019** dhe detyrimi vjetor për taksën mbi truallin do të paguhet pranë sporteleve të Bashkisë Maliq dhe Njësisë Administrative brenda **datë 30.09.2019**.
- Detyrimi vjetor për kategorinë truall për qëllime biznesi do të paguhet brenda datës **30.06.2019**.
- Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumëën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me **0,06 për qind** të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritët për një periudhë më të gjatë se **365 ditë** kalendarike. Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për biznesin është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq/ Njësitë Administrative.

2. TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Me “**hotel**” kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person. Detyrimi për taksën llogaritët si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel”.

Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel	Bashkia Maliq
Hotelet 4-5 yje	105 lekë/natë fjetje

Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35 lekë/natë fjetje
--	---------------------

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.

3.TAKSA MBI RENTËN MINERARE

Në bazë të ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, neni 4 pika 4 : Renta minerare llogaritet në përqindje të vlerës së siguruar nga shitja e mineralit të papërpunuar, të prodhuar nga zona e lejuar minerare, dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njësisve të qeverisjes vendore përkatëse. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. 5 për qind e të ardhurave ngarenta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.

Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës në % sipas ligjit	Propozohet në %
Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik	4-8	4
Ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër.	1-3	1
Për objektet e infrastrukturës për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshi makineritë dhe pajisjet në këto projekte.	0.1	0.1
Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5	0.5

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen, vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq.

5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me legjislacionin. Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

-Niveli i taksës caktohet në **lekë/m²** katror të bazës së taksës.

-Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

-Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.

-Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është **2 për qind.**

-Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij sipas tabelës që vijon :

Kategoritë e ndërtesave	Bashkia Maliq/ Njësitë Administrative lekë/m²
I. Ndërtesa banimi	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	300
III. Ndërtesa të tjera	200

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është **Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**, e cila në rolin e agjentit tatimor, përfiton 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

6.TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Drejtoria Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura bazuar në legjislacionin në fuqi, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësitëve qeverisjes vendore.

Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësitëve të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoria rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 18 (tetëmbëdhjetë)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësitia e qeverisjes vendore, dhe 77 (shtatëdhjetë e shtatë)% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj).

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të

administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. TAKSA E TABELËS.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Maliq.

Tabelat ndahen në:

I) Tabelë për qëllime identifikimi, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit);

II) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orioentim;

III) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme ose e palëvizshme ;

IV) Tabelë për funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, e.t.j.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Maliq është si më poshtë vijon :

I.	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)		
a	deri në 2 m²	lekë/m ² /vit	0
b	mbi 2 m² deri në 10 m²		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	7 000
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	11 500
	elektronike	lekë/m ² /vit	15 000
c	mbi 10 m² deri 20 m²		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	5 950
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	9 775
	elektronike	lekë/m ² /vit	12 750
ç	mbi 20 m² deri 40 m²		
	e thjeshtë(pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	3 850
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	6 325
	elektronike	lekë/m ² /vit	8 250
d	mbi 40 m²		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	2 800
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	4 600
	elektronike	lekë/m ² /vit	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	Tabela identifikuese	lekë/m ² /vit	120
III.	Tabela për qëllime reklamimi e lëvizëshme e palëvizëshme deri në tavanin maksimal 35 m²		
	e thjeshtë (me/ pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	13 500
	Elektronike	lekë/m ² /vit	27 000

IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda, reklamuese, banderol, etj.		
	të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m ² /vit	1000

Detyrimi i kësaj takse është vjetor dhe pagesa bëhet paralelisht me pagesën e taksave dhe tarifave të tjera. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, e.t.j., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejës së dhënë.

Afati i pagesës:

- Brenda datës **30.06.2019** për subjektet e regjistruara ;
- Për subjektet që regjistrohen pas datës 30.06.2019 **brenda 30 ditëve** nga momenti i regjistrimit.
- Gjithashtu të gjithë subjektet e tjera të cilat do të vendosin një tabelë gjatë vitit 2019 afati i pagesës është 30 ditë nga data e identifikimit dhe matjes së sipërfaqes nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

Taksapaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me **0,06 për qind** të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

- Struktura e ngarkuar për miratim për të vendosur tabelë identifikuese/reklamuese është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq bazuar kjo në kërkesën e vetë subjektit që do të vendosë tabelë identifikuese/reklamuese.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.
- Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos miratim për vendosje table reklamuese është Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

8. DHËNIE E LIÇENCAVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN PRODUKTEVE TË SAJ

Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE” të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8450, DATË 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 “PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE” të ndryshuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 për “PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KUSHTEVE PËR DHËNIEN E LIÇENCAVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN PRODUKTEVE TË SAJ” Bashkia Maliq jep liçence për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Maliq. Autorizimet jepen nga Bashkia Maliq **për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet** me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon.

- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete dhe vajra lubrifikante.

1,000,000 lekë

- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregëtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.

100,000 lekë

- Për publikatë për të njëjtin stacion dhe afat vlefshmërie apo rastet e ndryshimeve në liçencë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të stacionit paguhet 20% e vlerës së plotë.
- PAGESA nga subjektet të cilët do pajisen me autorizimin përkatës të behet në total (1,000,000 lekë për 5 vjet) ose me këste 200.000 lekë/ vit.

Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj liçence dhe vjeljen e detyrimit është Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Maliq.

B- TARIFAT VENDORE

Tarifat vendore aplikohen për çdo familje rezidente në Bashkinë Maliq, çdo biznes që ushtron veprimtarinë ekonomike brenda territorit të Bashkisë Maliq si dhe për çdo person fizik ose juridik të huaj që ushtron veprimtari në territorin e Bashkisë.

1.TARIFË PASTRIMI

lekë/vit

Kategorite	Maliq Qytet	Fshatrat për Nj.Ad. Maliq Pirq Pojan Libonik Vreshtas	Fshatrat e Nj.Ad. Moglicë Gorë
Familjarë	1500	1500	600
BV (0-2mil) Njësi tregëtare dhe shërbimi	6000	6000	3000
BV/TVSH (2-8mil) Njësi tregëtare dhe shërbimi	10 000	10 000	10 000
Restorant, Furrë buke, Baxho, Mobileri, Alumine, Supermarket	15 000	15 000	15 000
Tregëti materiale ndërtimi, inerte, mermere, plehra kimike	20 000	20 000	20 000
BM/TVSH (mbi 8 mil) Njësi tregëtare dhe shërbimi	50 000	40 000	40 000
